




YLLKAT E ENVERIT

Yllkat e Enverit

Nji broshurë përrallash pa mbret

Përgatiti

Lisandri Kola

Imazhi në ballinë

© Theo Napoloni

Kissing Enver Hoxha View

(Drawing on Empty Toilet Paper Roll), 2016

© Kêns, 2020

Prodhimi i plotë apo i pjesshëm i kësaj broshure lejohet me u shfrytzue vetëm për qëllime jokomuniste.

SHKRIMI im botue pak kohë ma parë,¹ me titullin *Nji kunorë për një krye* ngjalli debat mbi një proces aktual që po bahet në shtetin shqiptar, quejtë Poeti Laureat, nistue nga Qendra Kombëtare e Librit dhe [e] Leximit (QKLL).

Mendoj se kjo zhurmë ndodhi për tri arsye. E para, në frekuencën publike të diskutimeve u pà qartë se tema bazike të letërsisë shqipe, si ajo e realizmit socialist, nuk janë shterrue me cilësinë e duhur shkencore tash 30 vjet dhe se lexuesi shqiptar asht i paorientuem, e për pasojë pa kujtesë përkatëse (identitare, intelektuale e estetike). E dyta, histerizmi i disa personave të përfshimë në debat—së shumti komente rrjetesh

¹ <https://sbunker.net/op-ed/90688/nji-kunore-per-nji-krye/>

socialesh—dëshmon se Shqipëria ende nuk është ndërgjegjësue për damin e madh kombtar gjatë diktaturës dhe se ai shtet sërish e don dhe e kërkon një diktaturë edhe më të egër sesa ajo që po zhvillohet në postkomunizmin shqiptar. E treta, një motiv periferik si ai i rastit të lapsusit të një titulli poezie të z. Sadik Bejko, u instrumentalizue për me prodhue kamuflazhin e një paligjshmënie nga ana e Komitetit të përzgjedhjes së Poetit Laureat (KPL). Po ta nisim nga e arsyeja e tretë, po del e qartë se banalizimi i një çështjeje si lapsus referencial, viktimizimi, përdorimi me ngut i precedencës tue angazhues media që me e quejtë ‘falsifikim’ një dokument/faksimil që publikova vetë prej burimeve të Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë (BKSH), stereotipizimi i disa frazave komuniste, të bajnë me mendue për kakofoni të qëllimshme propagandistike. Po shpjegohem më qartë. Mbas ndjesës publike kërkuar nga ana ime z. Bejko, në profilin tim të Facebook-ut më datën 22 tetor 2020,² ky i fundit nisë prej pozicionit viktimizues e

² Në një komentim timin të djeshëm, mbi faktin se Juria e QKLL-së, nga 25 kandidatë pohoi se ishin 26 tue futë në 10-she poetin Sadik Bejko, pa qenë në listën fillestare (dt. 5 tetor 2020), pohova se është përfshirë S.B. autor i një poezie të hershme ‘Ditët Enverit të jetës time’, tue iu referue skedimeve të mia marrë prej Bibliografisë Retrospektive në BKSH. Fatkeqsisht konstatova se kemi të

ndërroi pllakën tue u ba akuzues e tue më quejtë falsifikator, së bashku me një aradhtë të gjatë kamikazësh poetikë që britnin *hossana* për z. Bejkon. E ftova sërish, mbrenda asaj dite me një komunikim tjetër publik,³ që të matej dhe të

bajmë me një lapsus të gjeneruem prej bibliografëve, ku në të vërtetë në vend të 'Everest' asht shënue 'Enverit'. Kjo më ban të marr kostot profesionale e personale përsipër tue i kërkuar ndjesë publike z. Bejkos për këtë keqkuptim e dam që i kam shkaktue. Bashkëlidhë fotoja e retrospektivit bibliografik 1972. {nuk jepet në këtë fusnotë, por asht publikue në profilin tim}.

³ARSYETIM APO IDHNIM? Po më duhet të baj një rikomunikim për sa shpjegova ma heret, tue dashtë me penetrue nëpër kanale aspak demokratike e liberale. Z. Bejko, apo kushdo tjetër që ka lidhje miqsie a jo me personin në fjalë, mundet me komentue në profilin tim të FB e ndërsa unë (as miqtë e mi) në atë të z. Bejkos JO. Kjo asht zgjidhje e tij, e menaxhimit të FB. Nuk ka asgja të keqe. Por, në këtë rast nuk më lejon të gjegjem në kushte të barabarta. Z. Bejko ju ftoj, meqë ju e keni të bllokueme faqen e FB për komente, për hir të transparencës publike, ta adresoni zhvillimin e dialogut tuej në faqen time, dhe jo me u kujdesë për 'të vërtetën' që po thoni: dmth. me kundër-të vërtetetën!

Qysh në krye, kërkoja prej z. Bejkos durim në verifikimin e njësive, gja që unë i kisha pjesërisht në fondin tim personal. Kjo gja desht një orë të natyrshme-fizike, sa të zbardhte dita në Shqipni. Me t'i verifikue njësitë, konstatova se kemi të bajmë me një gabim njerëzor të Bibliografisë së Periodikëve në BKSH. Ato faksimile që publikoi z. Bejko në profilin e tij (të cilat janë të bashkëlidhuna edhe këtu ma poshtë {nuk jepen në këtë fusn.}, tashma për transparencë ma të madhe 'me evidentim të verdhë' [ba prej meje në mjes për lehtësi komunikim] e 'pa evidentim', sikurse asht nga NJISIA përkatëse e fondit bibliotekar), kanë dalë prej meje, për me qenë transparent dhe me dëshmue të vërtetën.

Gabimisht, qysh dje, z. Bejko deklaroi se unë kam pasë qëllime negative dhe nënvlerësim për poezinë e tij. Kjo nuk asht e vërtetë: unë kam citue vetëm titullin e një poezie të tij 'tashma të keqshkrueme', gja për të cilën kërkoja ndjesë publike tue marrë mbi vetë peshën profesionale-personale, po ashtu edhe për insitucionin ku ruhet (SIÇ JEPET/E DHASHË NË IMAZHE). VERIFIKOJENI dhe krahasojeni me fl. 41 të bib.retrospektive, të periodikut, në BKSH. Ajo nuk

asht falsifikue nga ana ime. GABOHENI. Nuk asht në natyrën time të punës me falsifikue. Unë nuk e publikova foton-faksimilin e faqes së gazetës, për mos me shty ma tej një debat, që mund të merrte lëndime apo pesha të tjera emocionale për juve, z. Bejko. Falja publike, prej një gabimi njerëzor-bibliografik (pra që nuk varej/t prej meje në këtë rast), për sa kuptoj vetë, nënkupton edhe ndjesën time ndaj jush si person. Ju siguroj se NUK KA ASNJI PHOTOSHOP – të paktën, ju lutem mos supozoni dhe akuzoni pa të drejtë. Verifikoni dhe mandej, mbani qëndrimin tuej. Meqë ju komentuet, pastaj, në profilin tim, mbi a nën komentet e mia, apo të dikujt tjetër në faqen time, jua postova edhe faqen e poezive në ‘Drita’ 1972/10 dhjetor, f. 10, tue ju kërkuar me mirësjellje që ta lexoni edhe qëndrimin tim. Dmth. edhe ata sinkrone fotografike që keni ju, kanë dalë nga unë, e qarkullue mandej prej disave. Këtë dëshiroj t’ia bani me dije pjesës suaj të miqve, që tashma e kanë lëshue turrin pa kuptue asgjë. Me randësi asht që BKSH në ripunimet e veta me e shkruar korrekt titullin e poezisë suaj, gja për të cilën kam besim të plotë se ndodhë në një të ardhme [online]. Edhe ma me randësi asht që BKSH me e konfirmue AUTENTICITETIN e njisisë që unë kam shpërnda. Gja që mund ta kryeni vetë apo cilido tjetër, i interesuem. Pra, për një material të aksesueshëm nga kushdo (i verifikueshëm!) si mund të spekuloni për falsifikim? Mbase asht me vend që këtë barrë, që po adresoni ndaj meje, pa të drejtë, ta kërkonte në një institucion, materiali i të cilit asht tash sa dekada në atë formë, pra ME PASAKTËSI REFERENCIALE që i njeh dhe vetë sektori i Bibliografisë, në BKSH.

Tash me keqardhje shoh, se keni postue një qëndrim tjetër!

Në asnjë moment të vetëm në jetën time, nuk kam pohue se jeni ‘spion’. E që e konfirmoni vetë që nuk keni qenë as spion as komunist. Kjo asht në nderin tuej! Sikurse edhe për kolegët tuej që kanë qenë të tillë; edhe kjo besoj se asht në nderin e tyre. Nuk kam asnjë kundërshtim.

Biseda me ju, po e ritheksoj asht rezultat i një KEQSHKRIMI të titullit të poezisë, dhe ju si autor e poet jeni krejtësisht jashtë fokusit tim të debatit që kam parashtrur. Për komentin që pata ba, mbajta qëndrimin tim tue e fshirë e kërkuar ndjesë publike. Prandej, due t’ju siguroj se nuk asht në kriterin tim me ba ‘pis’ askënd. Unë e konsideroj publikimin e një poezie, në çdo rrethanë, të mundshme akt-komunikimi dhe jo ‘fshehtë’. Asht njëkohësisht jashtë qenies sime me ju prekë në plagë, sikurse shkrueni, as ju as dikënd tjetër. Tashma se çfarë ka në atë poezi, çdokush mundet me e lexue vetë. Ndërkohë, Lisandri & co., e cila ka në kompani VETËM personin tim fizik-juridik, e mirëkupton ‘haraçin’ e kohës, por ma shumë mirëkupton ata që nuk pranuen me pague detyrime të tilla. Pra HESHTËN.

artikulonte në mënyrë ma të përgjegjeshme, por ndërkohë makineritë e propagandave ishin vû në punë: faqe online, disa gazetarë jashtë çdo standardi minimal etik e profesional, faqe gazetash, shkrimtarë që bajnë temena etc.

Tue qenë një material i dalë prej meje, dhe z. Bejko së bashku me këdo tjetër ka riciklue të njejtin material, ai njëherësh më ban mue përgjegjës dhe BKSH-në. Ky insitucion nuk pati

Kah fundi i shkrimit thoni: *'Edhe për partinë do të këndonim, se ishte me detyrim. Se ndryshe nuk do të ekzistonim.'* Kjo, pra, asht zgjedhje me vullnet konkret. Edhe MUHAMET ADEMI, ZEF ZORBA a PRIMO SHLLAKU (a ndokush tjetër që e kam ba publike kahmot, në shkrimet e mia) kanë ekzistue në formën e vet: herë si 'lule nate', herë si 'liri e fijos së barit' e herë me 'buzë të ngrira në gaz': pra të gjithë nën diktaturë. Kjo asht pjesë e ndërgjegjes së secilit.

Si duket, fjalët e e mia, nuk kanë vend në qëndrimin tuej sepse 'nuk jeni idhnak'. E për këtë suportuet ndonji media [si alb-spirit], për me POHUE 'FALSIFIKIMIN' e 'NJI MOSFALSIFIKIMI'. Ju përgëzoj tej mase për ngutën dhe mungesën e racionalizimit.

Pra, z. Bejko unë ua përsëdyta qëndrimin tim të vërtetë e të singertë, në çdo konsekuencë të mundshme. Kjo tashma asht në dorën tuej, ta konsideroni apo ta spekuloni. Por, ma kryesorja në këtë debat, edhe pse asht qëndrimi i detyruem i Komitetit të QKLL-së, asht pyetja se a e pranoni ju si poet dhe si qytetar i ndershëm i RSH, që më qenë në 10-she pa qenë në 25-she? Nuk e di a mund të keni një shpjegim për këtë gjë. Kjo besoj se asht katapulta ma interesante e këtij kompeticioni për dafinë. Tue mos ju interesue honorifikime të tilla, siç shpreheshit, ma do mendja se mundeni me e orientue këtë bisedë ma me pleqni. Ju uroj shëndet e punë të mbarë,

Jueji

Lisandri.

P.S. Enveri sado i lartë nuk ka lidhje me Everestin, paçka indeksit!

ndonji reagim publik për këtë rast, por si ish-punojës i atij institucioni po tham me bindje *se ai vend nuk asht vend falsifikimesh*, por vend pune intensive pavarësisht situatës të këtyne vjetëve të fundit. Dhe natyrisht, kush punon edhe gabon! Të akuzosh një institucion, në 100 vjetorin e tij, dhe njëherësh kërkuesin që ia asht referue burimit të atij institucioni, të ban me mendue për tollovë qëllimore, që me humbë gjurmë për praninë e tij në shortlistë pa qenë fare në listë. Institucioni i QKLL-së dështoi sa herash në shpjegimin e tij. Po merret vesh se ky institucion që e ka krijuë Poetin Laureat (PL) nuk asht i kthjellët vetë, por po futë disa persona që me plotsue arna-arna se në çka ‘konsiston’ njimend PL, dhe cilat janë kriteret shqiptare në krijimin e këtij posti. Ma e rëndësishmja asht, se mbasi z. Bejko së bashku me gugatjet pro-histerike e vërtetoi se dokumenti që kisha paraqitë ishte origjinal, dhe i pafalsifikuem. Nuk kërkoi falje, as mue as BKSH-së. Edhe kjo asht në nderin e tij. Një tjetër fakt, që të ban me e marrë në konsideratë asht devijimi i pyetjeve që ai

dha për gazetaren Fatmira Nikolli si në insertin e videos⁴ si në opsionin shkrimor.⁵ Natyrisht kjo asht çështje personale e tij, por një ndër dy temat bazike të shkrimit tim *Nji kunorë për një krye* (1) përjashtimi i poetëve shqipshkrues dhe (2) skarcimi i grupmohës nën 45 vjeç asnjherë nuk morën përgjigje, as nga ky i mbrami as nga KPL apo QKLL-ja. Mbase në fund fare merret vesh...

Për me u lidhë me arsyen e dytë, të shumë zhurmë për asgjë d.m.th. produktin socreal, me trishtí dallohet një koalicion miqsor që reagon, dhe nuk arsyeton apo ndryshe shkarkon neuronet e veta pa iu referue fakteve konkrete. Por reagimi kakafonik, siç e përmenda, asht përpjekje për me e amnistue periudhën e propagandës letrare gjatë diktaturës. Siç e kam shprehë: *‘Nuk propozoj modelin e përndjekjes së Javert-it ndaj Jean Valjean-it assesi, por nuk pajtohem me shoqninë shqiptare, me intelektualët e kritikët që e kanë braktisë Mnemosinën për me*

⁴https://www.youtube.com/watch?v=d4z5BQSHA6w&feature=youtu.be&fbclid=IwAR09LNFtf78OFXkITqrBMvKxCeIV072qyLeCokgTz1Xw0PJq_YsnbcC4kzA

⁵ <http://gazetashqiptare.al/2020/10/24/intervista-sadik-bejko-mbi-poetin-laureat-e-haracet-tona-dikur/>

*mbushë bulshijtë në ujnat e Lethes.*⁶ Nëse nuk e kanë në mend (ata socrealista), të cilët janë gjallë me kërkue ndjesë për damin estetik e ideologjik, që kanë përçue tek lexuesi tue e ba sot deri të pafërë, të paktën të kenë ndjeshmëni ambientaliste-ekologjike. Të lypin falje për tanë atë drû që kanë shpenzue tue prodhue letra e libra me tirazhe deri në 20.000 kopje gjatë propagandës moniste.

E dyta asht varësisht e lidhun me të parën, me mungesën serioze të studimit të autorëve socrealë, që janë kthye e tansformue, në shoqninë shqiptare, sikurse në politikën e kësaj kulture. Këtu nuk asht problemi me e lidhë këtë ngjarje shqiptare politikisht, por me e konsiderue ideologjinë artistike të së shkuemes së tyne si pjesë esenciale e fazave të tyne shkrimore. Dëshmitë e teksteve tyne, nuk janë ekuivalente me dosjet e Sigurimit të Shtetit siç pipëtojnë do zaje ndër bërakatat e Tiranës, por tekstet janë teste të një epike ogurzeze. Askush nuk foli deri tash (jashta komenteve

⁶ L. Kola 'Nji kunorë...'

sporadike në rrjete sociale) për ata që **nuk shkruen** në komunizëm, ata që nuk paguen as *haraç* as *bakshish*.

Në këtë pikë, nëse amnistohen poetët e dikaturës, haraçmenët dhe bakshishaxhijtë, nuk shoh me vend atëherë që të kritikohet Kadareja për të shkuemen e tij prej socrealistit. Kështu që taborristat e gegënishtes, ata që kishin me zgjidhje fatet e asaj traditë përmes instituteve inaktive, jam i mendimit se tue e panue veten në një kompeticion jogjithpërfshimës e të instrumentalizuem prej vjegëzave komuniste, duhet të dëftohen të matun kur ta mprehin shpatën ma për debate publike ndaj të shkuemes së Kadaresë si *Vox Kommunismus*. Gjykoj dhe i mëshaj bindjes sime, tue pasë në mend të gjithë viktimat e komunizmit shqiptar, se konjukturaliteti dhe dëshira për konkubinazh mediatik nuk duhet me e ba personin aleat me një event që në thelb nuk përçon vlera të shndoshta kombtare si PL. A thue s'dit me pague haraç Havzi Nela—martiri i fundit ndër poetë? Po Át Donat Kurti, që vdiq në skam me shumë të tjerë? Po Musine Kokalari a s'mujt me u kompromentue? Po a s'kishte ditë me lanë bakshish Arsi Pipa ndër duert e Sigurimsave? Po vetë Uran Kostreci a thue

kishte ditë me e pague haraçin a me dhanë bakshish? E saesa të tjerë, të ekziluem apo të destinuëm me jetue a vdekë në (post)komunizëm. Prandej ju ftoj ta zgjidhni sofrën se ku doni me u ulë, **ndër dy sofra s'keni vend.**

Tue u lanë, pra, gjanat e padiskutueme dhe tue u zhvillue të shumtën virtualisht si debat, sot çështja e trashëgimisë së një poezie propagandiste, ofensive, inergjenocidiale, ateiste, servile, me dam të madh kombtar e estetik, **NUK ASHT DISKUTUE KURRË.**

Nisë prej paragrafit të masipërm, tue e lidhë vetëm me poetët e dhetëshes në PL dhe një pjesë të produktit tyre, pa e harrue Kryetarin—se rreshti nuk mbaron—ju ftoj të krijoni një lexim personal sesi janë edukue brezat e ndryshëm (prej te fëmijët, maxhorenët e deri tek mosha e pjekun) përmes një *vox-i* unjissues.

Titulli i kësaj broshure me përralla *pa* mbret asht nxjerrë nga një varg i një prej kandidatëve për PL. Ndërsa një poet tjetër në listë, për arsye sensibilizimi me rastin e tij familjar, nuk asht gjykue me u përfshî në këtë broshurë.

Faqet e gazetave **të plota**, ku del edhe emni i ndonji poeti/eje tjetër asht fshî sepse nuk asht në interes studimi, por as e nevojshme me u ba publike. Kush ka dëshirë për lexime ma komode a integrale, asht i lutun t'u drejtohet bibliotekave të ndryshme të Shqipnisë, ku ruhen librat dhe periodikët.

KENS

RUDOLF MARKU

Sallë e Kongresave, Gjeograf e vendit,
 releuet e maleve jona në këtë sallë,
 Ja lumi Dri në lampat e ndezura,
 Ja zemrat e njerëzve - barmaleet në të lartë.
 Sallë e Kongresve, Malet e Dukagjinit
 jona muret e tua me kokën në qiell;
 nga hapësira e pastër e shpirtit të njerëzve
 ti rritet me tepër se nga dhjetëra ditë.
 Tavani i lartë është qalli shpirtor,
 poshtë këmbëve tona te ti barin ndiejmë,
 At malësori që kërkoi nga puna në murg
 është detyrë i fundit që t'ij.
 Sallë e Kongresve, Të shohim ty
 dhe ecim rripave të historisë
 Aha! si ndiejmë të historisë
 te Ty ndiejmë Themet e Shqipërisë
 Sallë e Kongresve, Portretit i Enverit
 me buzëqeshjen e madhe të njeriut të gjallë,
 Gjeograf! Korrigjenti i lartësirë e malësirë,
 me Enverin malet bëhen më të lartë!

Parti!

Ti më dhe moshën e të gjitha kohrave
 dhe hapësirën e të pesë kontinenteve,
 sepse ti më mësove gjërat më të domosdoshme, -
 sekretin për të mos u rrëzuar kur gjunjëzohen të tjerët.
 Sekretin për të parë burrin brenda fëmijës
 dhe fëmijën e gilltër brenda çdo burri,
 më mësove të shoh shëkujt brenda casteve kalimtare,
 ti më dhe sekretin e grurit e të duarshtrëngimit.
 Më bëre të shoh çmimin e buzëqeshjeve të lajkatarëve,
 më mësove të shkatërroj dhe të ndërtoj njëherësh,
 më dhe sekretin e shëmbjes së altarëve
 dhe të ecjes mbi shpinëkrrusjet dhe mbi gjithë poshtërimet.
 Më mësove dhe njëherë riezbulimin e vetes.

8 Nëntor

1. Eshë një ditë e zakonshme e vjehtës së trete, gjithë bien sipas ligjit me të vjetër në botë. Mbi malet, në gryka luginash, lirin era, me gjuhën e saj djepa se ç'fshij.

Një ditë e zakonshme, një ditë si të tjerat, pas shtatës vjen teta, aritmetikë e thjeshtë. Por ja, atë ditë, në të gjitha orët kurdiet eve e hahet vete.

Një ditë si të tjerat. Me mëngjes, me muez, në rrugët e shpurnshme shkollorë plot bujë.

Por çini veshin. Nga Varrezat e Dëshmorëve armatë e të vëmë lëndojnë si dërras.

Një ditë e zakonshme. Një ditë si të tjerat, poshtë atëvëse futesh po që se bie shi: në rrebeshe-kohërash, pa trokitur, pa lajmes të dita e Tete hyrë, Shqipëri.

2. Sallë e Kongresëve, Gjeograf e vendit, reliefet e malinorëve në lartë sallë. Ja, lumi Drin në llampat e ndezura, ja, zemrat e njerzëve - vargmalet më të lartë.

Sallë e Kongresëve. Malet e Dukagjinit janë muret e tua me kokën në qiej; nga hapësira e pastër e shpirtit të njerzëve ti shikojmë me tepër se nga dhjetëra dje.

Tasori i lartë është qielli shqipëri, poshtë këmbëve tona të të barin ndiejmë. Ai maledori që lëkëhet nga puna në muez dhinë delogati i fundit që vjen.

Sallë e Kongresëve. Të shohim ty dhe eim rriptraut të historisë. Ashtu si ndiejnë rrënjet poshtë penëve me fruta të Ty ndiejmë Themelet e Shqipërisë si Partisë.

Sallë e Kongresëve. Portreti i Enverit me buazqeshjen e madhe të njeriut të gjallë. Gjeografet Korrigjoni lartësitë e maleve, me Enverin malet bëhen më të lartë!

3. Partia ime, në atë ditë të tëte, në atë ditë të vitit dyzet e një shekujt që them dhe shekujt që vijmë ndaluan dhe thanë emrin - Shqipëri.

Thanë hallxehinjtë e njerimit shkollor: - Kjo është dita e besimit të njeriut i thjeshtë! Të rrezohen idhujt nga lartësia e atëvës, të lartësohet ai që prodhon vetë!

E dinin ata: kish lindur Partia. Dielli një rrugë tjetër do lësh. Përmbi urinë e vjetër as bota orët e hakmarrjes gjejmuan nadhërisht.

E dinin ata, kjo ish-dita e ditëve, loka më dysh do ndaloj parkelloj. Nes mjeputlase dhe errance të acarta Shqipëria kishte diellin e saj.

Të vërtetat e thjeshta, të fshehura në shekuj, fshja -bukë, fshja -drejtësi- sikur u zbuluan atë ditë së pari për të ngjitur të vlera joje - Njeri.

4. Më kanë trazur se në këmbë e luftës kur dajgashin ditët, rrezqeshin kombe një maledor, larg nga ngjarjet e botës, kallaste në një cep lopot.

Por një ditë luftëtarit i kaluan pranë se dajgje bota, dajgje Shqipëria. Ai kllarin e lëshoi nga dora dhe mori pushkën të vinte liria.

Vetët bëhesh lufte e madhe, dajgashin shietë, gjeqeshin kombe. Po ja e diti se për fshatarin

Çkuptim ka pëllitja e lopot.

Me luftëtarët u bashkua ai gjer në fundit.

- Edhe këtu është Partia!
Mendua unë.

5. Kam parë një ditë (me njeri që do prisë të dajgim nreko lita), ngjarje që veshi i hap rrallë, kam parë një dajë

dhe një burrë pranë tij, Jeppin, merrnin, shanin, djeritnin. (Në acatë, mos shtatimose të motorëve gri). Djali si veshkall që hapet pas pemës dhe burri që fshet zellat, me tual, me shazje, gjithë nerna, gjithë fshet pranë loma si fllorë, të metalë.

Qeshi papritur burri, usina gjeimoi nga e qeshura e tij dhe oetëm atëherë djali ngriti kokën dhe po nga ai.

Djali si veshkall që hapet pas pemës peshqijellur pas beutit të burrit pranë. Çkuptim do kishte usina në mizësinë e tyre, valle?

Në mizësinë e tyre:
Ai - burrë
Ky, tjetri: lartë i ri,
të pashe sërish, ty Partia!

6. Partia!

Ti më dhe moshën e të gjitha kohrave dhe hapësirën e të pesë kontinenteve, sepse ti më moshën gjerat më të domosdoshme, sekretin për të mos u rrezuar kur gjuqizohen të tjerët. Sekretin për të parë burrin brenda fëmijës dhe fëmijën e çitër brenda qd burri, më moshën të shoh shokujt brenda qatëve kallmatore, ti më dhe sekretin e grurit e të auarshtrëngimit. Më bërë të shoh çnatin e buazqeshjen të laskatarëve, më moshën të shkallërojt dhe të ndërrjot njerzësh, më dhe sekretin e shëmbës në atëvërë dhe të eces mbi shpikëtrazujt dhe mbi gjithë poshtërimet.

Më moshën dhe njërëri rrahulim e vates.

7. U prene shiritat për usinat e regj, përurohen shkolla, një muze, një fabrikë dhe një ndërroj të priten shirit të kallër qiejsh edhe për dashuritë.

Po prit, kush flet me ballin e ngryzur, se ja, dashuria është lodër në erë, se ja, dashuria është proekt fëmijësh, se na sot pastemi probleme të fjerë!

Harron ai se në vitet më të egra kur djem dhe vajza mberrnin Britë, Margarita Tsatuni në moshën më të bukur dhe dashurinë për të gjitha dashuritë.

8. Qyteti i Studentëve. Endra të pastra, endrat me të bukura që jesh parë në botë; shikime projektsh, prolod dashurie kryeqeshen me dhembjet e kontinenteve sot.

Rrugë të zakonshme me gjehtë të përfshakura (Për një cast me plagët ngajnë gjetiet e vëna), buazt e dashurura vëletuq hapen, peshqijellur këqim: -Dhlogodale po vjen...!

Qytet i dashuruar, me endra të pastra, me andra rinore që s'palek anshpërh. Mediolitri, karrieristët, ata që nxijnë si nata, qytet rinor, mos të mbishijnë në derë!

Partia ime! Në mbërrmjet e vona me studentët shëttimn delegatët bashkë, ata që erdhin nga fshatit me grurë, ata të minierës të dajgës të lartë.


9. Kur ishim fëmijë dlinim mes errërae, hapim krahët gati për fluturim, dhe shuha na shlynte përpara, përpara, mes botës, mes rrugëve të pajfundme, mikim im.

Qëllonte pastaj që udhëve të mëdha të shkllim një penë të thyer, një degë dhe në e kuptimim: Do rrezqesh, kush do përdiejë gofte dhe njërëri.

10. Eshë një ditë mes ditëve të tjerë të nëntorë që rr si bedem mes bedenëve të tjerë, është dita që ka arkitektuven e zemrave, është dita që ka emrin e të shtrënjtit Enver.

Shqcpa - themelimit, Pallati i Kongresëve - Themelet e tyre i kanë në një ditë. Ashtu sic bashkohen lumenjtë të detit, bashkohen të ty ditët e tjerë, - të gjitha.

Eshë dita e ditëve kjo ditë nëntori, ditë kur lindi ti, Parti. Dielli ka një rrugë të vetën ku vërtitet: vërtet të vërtetase të tua, Njeri.



Shqipërisë

Ti s'pyet, nuk pyet për sulmet se nga vijnë
po dhe syrin kurrë nuk e lot.
Në rrugën tënde-diell gjithnjë Partinë,
në duar pushkën-mbushur, krehim plot,

E mbrohesh ti me krahët e tu të zjarritë
e në ndërtime prag me forcë t'veta.

Ti sot mbi rruzull qehesh mal i lartë,
kala e kuqe shqipeesh krahësihta,

NATASHA LAKO

Partia dhe fëmijët

Erdhët edhe ju në shtëpinë
ku lindi Partia
e në pragu e saj për herë të parë
hapin ndalet,
e gati jini që të prisni orë me mijëra,
që ajo të dalë,

Gati jeni që të rriini pa gjumë,
në atë prag të thjeshtë,
derisa ajo koken mbi ju ta përkulë,
t'ju përshendetë.

E prisni, Dëgjoni të rrahurat
e zemrës suaj të vogël
e thoni se ndietë papritur hapat e saj.
O ju fëmijë më të mëdhenjtë e kohërave,
që zemra një hap të tillë iu mban!

Zjarri partizan

Dimri e kish përzënë diellin
prapa reve e përtej globit.
Nata fshehur e kish vendin,
poshtë territ dhe të ftohtit.

-Ç'diell t'ju ndez, bij partizanë?
pyeste si një nënë koha.
Prej atij zëri lisi i lashtë
si zjarr për trimat u filloka.

-E kam brenda zemrës diellin.
Ditën unë në trup e kam...
Flakë nate e dimër djegjin...
Ndizet zjarri partizan.

Aldheu

Për mua fëmijën Aldheu ishte zëri i nënës,
krahët e babait kur me ngjinte drejt llambës,
përallat e gjyshës për ujkun dhe qengjin,
dhe ato pak metra katrorë të dhomës.

Çdo ditë si për çudi ai zgjerohet para meje,
zbriste shkallët e pallatit dhe bëhej udhë,
futuronte me zogjtë e shumtë dhe bëhej cerdhe,
gurgullonte me përroit e vogël dhe bëhej lumë.

Pikërisht: stëherë morëm udhën e qytetit.
Unë shqyeja sytë mbi samar e pyesja:
shuegu i pjerrët, malet e larta, njerëzit
ishin Aldheu të gjitha (!)

U dashën shumë vjet të kufioja Aldheun,
pyesësin e tij, njerëzit, gjuhën, këngët,
udhën ku ecte, qendresën, armiqët,
të gjallët dhe të rëmt.

Nëntor

Sinjali

i borizanit

Ja, borizani:

Për çdo mëngjes,
kur del ai
i shpërndan yjet me bori,
gjër të vijë mbrëmja
e t'i thërrasë,
në kupë të qjellit,
përsëri.

Dy buzë mbi pipë:

sinjali i tij;
porse në çast
ato e ngrënë
të gjithë repartin,
e bëjnë erë.
E zgjojnë nga gjumi
tërë qiellin.

E ndezin ëndrrat
lënë në mes.

Si t'ije lidhen amanetet,
në vjetë e shokuj
nëpër gjithë brezat.

Mbi maja malesh gjër tek retë
fluturimin merr shqiponja.
Ç'ka ky vend e ky popull?
Gaz i madh në vatrat tona!

Dhe ky metal-mes llavës-zjarr
na i ndez gjokset flakadan,
kjo digë e lartë sa ky mal
dhe ky varg dritash në Koman.

Gjithë këte fusha e burime,
gjithë këto fshatra kaq të bukur,
e tok me to dhe zemra ime,
me plot gëzime është mbushur.

Dhe tej në det daliga rreh brigjet
can delin mes për mes anija,
dhe këngës sime i përgjigjet,
bëhet gjënim kur fryn stuhia.

E ku s'të ngritëm Shqipëri
me lule, grurë e çelik.

Tek ty e kemi piramidën
dhe ty askush s'të prek një çikë.

A mund të preket toka valle
që ne na lindi e na rrit?

Në gjokset i bëjmë kështjelle
beton e hekur dhe granit.

BARDHYL LONDO

BARDHYL LONDO

Emri i Enverit

Ne ishim fëmijë. Nga Jugu, nga Veriu,
fëmijë të matur, fëmijë çapkënë.
Dhe ndonëse nuk e njihnim fare njëri-tjetrin,
Yllka të Enverit të gjithë u bëmë.

Ne ishim shkollarë ca bjondë, ca brunë,
të bukur të gjithë si një dritë.
Dhe ndonëse emrin s'ia dinim njëri-tjetrit,
Pionierë të Enverit u bëmë të gjithë.

Ne ishim të rinj, plot ëndrra, plot shpresa,
gjaknxehtë si rrufeja, paqëtorë si ylberi.
Dhe ndonëse njëri-tjetrin s'e kishim parë kurrë,
na bashkoi të gjithëve armata e Enverit.

Ne jemi burra nga Jugu, nga Veriu,
të heshtur, të zhurmshëm, të butë, të sertë.
Dhe në mos e njofshim kurrë njëri-tjetrin,
emri i Enverit na ka lidhur përjetë.



Dita e përcorisë

Pavoti

Pesa germa,
qesherajne të gjitha fjalet,
fjala sythash,
fjala dallgash.

Pesa germa në mesojne sekretin,
se si të perqafojmë me gjelbërimin,
si ta mund dritën,
Si ta shkurij bymën, ngricën,
borën e bardhë bërë akullit,
si ta lëshoj fashitën e tyre
në frymëmarje buambeshash, zogjsh, flijesh bari,
në frymëmarje të trëndafilit femijsh,
në frymëmarje vajzash të sopolakuruarat,
në frymëmarje të vallet ditësh.

Si ta prekë endrën, fantazinë,
si ta mbush jetën tëj e përtej me diell,
si të lëshoj fjalit në bledën bese e qëndrese,
si të jlosojmë me të ardhmen,
q'fjalë t'u them pronovrace.

Pesa germa
m'i gjelbëronë të kalër sinitë
e jetë sime.

BARDHYL LONDO

Enveri, i Enverit

Në ishim femija nga Jugu, nga Veriu,
fëmija të matar, fëmija copkëndë.
